

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Rasim Rasimi dhe Have Haliti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarave: K.M dhe N.L, për shkak se në bashkryerje kanë kryer veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 2 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK-së, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.22/13-830/12-PR1 të datës 07.06.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.05.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarës K.M, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, PKR.nr.22/13-830/12-PR1 i datës 07.06.2013, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin, PKR.nr.22/13-830/12-PR1 të datës 07.06.2013, të akuzuarat K.M dhe N.L, i ka shpallur fajtores për shkak se në bashkëryerje kanë kryer veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 2 lidhur me par. 1 dhe neni 23 të KPK-së, për të cilën veprë të akuzuarat i ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti, në të cilin dënim iu është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej 18.07.2012 deri më dt. 07.06.2013.

Të dëmtuarën për realizimin e kërkesës pasurore e ka udhëzuar në kontest civil.

Janë obliguar të akuzuarat që të paguajnë paushallin gjyqësor secila veç e veç shumë prej 50 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarës K.M, av. Y.H, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të shkeljes së ligjit penal, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështjen ta kthen në procedurë të serishme.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit me parashtrësën PPAM/l.nr.3/2016, të datës 05.01.2016, ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarës të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në pajtim me nenin 390 të KPP-së, caktoi seancën e kolegjit për të cilën seancë u njoftuan Prokurori i Apelit, të akuzuarat, mbrojtësi i të akuzuarës dhe pala e dëmtuar. Në seancën e kolegjit nuk morën pjesë: palët edhe pse kanë qenë të njoftuara në mënyrë të rregullt.

Gjykata e Apelit pasi që i shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë gjeti se :

Ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e mbrojtësit të akuzuarës K.M, pretendohet se Aktgjykimi i ankimuar nuk është përpiluar në kuptim me dispozitat e nenit 370 të KPP-së, si pasojë e së cilës në vete përmban shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 384 par. 1 pika 1.12 të KPP-së, meqë në aktgjykimin e kundërshtuar nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat janë ato fakte për të cilat kjo gjykatë i ka konsideruar si të vërtetuara, kur të akuzuarën e ka shpallur fajtor dhe gjykuar. Pretendohet se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij, dhe në kundërshtim me arsyetimin e aktgjykimit, pastaj aktgjykimi nuk përfshin arsyetimin lidhur me faktet vendimtare, ndërkaq ato arsye që janë dhënë janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse në masë të madhe për çka aktgjykimin e bëjnë të paqëndrueshëm. Nga dispozitivi i aktgjykimit, nuk mund të nxirret një përfundim i qartë se në të vërtetë se cilat janë ato veprime të akuzuarës Kosovare që do ta bënin përgjegjëse për veprimet e saja këtë të akuzuar.

Aktgjykimi i shkallës edhe pse ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi dhe në këtë aspekt konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së, dhe gjeti se aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij dhe as shkelje të Ligjit penal në dëm të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike të cilat i aprovon edhe kjo gjykatë. Gjykata e shkallës së parë, i vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merre si të provuara ose si të paprovuara dhe njëkohësisht ka bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Gjykata e shkallës së parë ka bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë, duke i paraqitur përfundimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Dispozitivi i aktgjykimit është i qartë, nuk përmban kundërthënie qoftë me vetveten ose me arsyetimin e tij. I pa bazuar është pretendimi ankimor se gjykata aktgjykimin e ka bazuar në prova që nuk ka mbështetje të duhura në provat e administruara, sepse gjykata e shkallës së parë me administrimin e provave në mënyrë bindëse ka vërtetuar se e akuzuarja e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë. Gjithashtu, i pabazuar është pretendimi ankimor sa i përket asaj se nuk qëndrojnë elementet inkriminuese të veprës penale të akuzuarës, sepse me vlerësimin e provave është vërtetuar se të akuzuarat me qellim të shfrytëzimit të dëmtuarës e cila ishte e strehuar herë te njëra e herë te tjetra e akuzuar, ishte mbajtur në frikën për të mos u treguar të afërmeve për vendndodhjen, ishte transportuar me taksi prej një restoranti në restorantin tjetër kishte vallëzuar së bashku

me të akuzuarat. Drejtë është vërtetuar se të akuzuarat vepruan qëllimisht dhe me dije të plotë ndaj pozitës së të dëmtuarës, ato vepruan vetëm për të përfituar duke e futur në vendet të cilat i frekuentonin e sidomos kur ka vallëzuar e atë në hotelin "Kristal" ku është paguar dhe më vonë për të siguruar përfitim nga aktivitetet e saja e të ia lehtësojnë bindjen e saj të mëtejme për punë të tilla. Duke vlerësuar aspektin juridik gjykata e shkallës së parë drejtë ka gjetur se në veprimet e të akuzuarës ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje trafikimi me njerëz nga neni 139 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarës në ankesë e konteston edhe gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, duke pretenduar se me provat e administruara nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, me pretendimin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar gabimisht provat e administruara dhe ka nxjerrë konkludimet e gabuara përkitazi me veprimet e të akuzuarës duke e shpallur fajtor të njëjtën edhe pse e njëjta nuk e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtorë, sepse në veprimet e saja nuk qëndrojnë elementet e veprës penale.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të mbrojtësit përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk qëndrojnë. Siç rezulton nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar del se edhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje siç pa të drejtë pretendohet në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit. Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë, për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike ka administruar provat, ka lexuar deklaratën e të dëmtuarës A.A, të dhënë në stacionin policor më dt. 18.07.2012 dhe para Prokurorit të Qarkut më dt. 31.08.2012, ka dëgjuar dëshmitarët Q.A, M.I, F.T, N.V, A.M, R.S, Sh. M dhe A.K.

Me vlerësimin e deklaratës së të dëmtuarës A.A, të dhënë në polici, po ashtu edhe në prokurori, e njëjta ka përshkruar ngjarjen se si është takuar me N, si ka shkuar në shtëpinë e saj, si i është frikuar asaj, se nëse tregon vendndodhjen do të lajmërohet në polici, si është njoftuar me K, si është shoqëruar, si ka shkuar me te në V, si është njoftuar me shokët e sajë në ..., si kanë shkuar në Gj, në hotelin "Kristal" si i ka ofruar N, që të krijojë marrëdhënie seksuale të cilat gjykata i ka vlerësuar dhe në bazë të kësaj ka gjetur se e njëjta përshkrimin e ngjarjes e ka bërë në detajet konkrete dhe të cilat janë rrethana që një dëshmitar i sqaron në një vend kronologjik pa zbrazësia dhe kundërthënie në mes tyre e të cilat mund t'i dëshmon një e dëmtuar nëse vetë i ka përjetuar. Gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e prindërit të dëmtuarës Q.A, si dhe dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë nga të cilat prova është vërtetuar në mënyrë të drejtë gjendja faktike dhe pretendimet e mbrojtjes se në veprimet e të akuzuarave nuk ka pasur elemente të veprës penale nuk qëndrojnë nga vetë fakti se e dëmtuara është fëmijë, qoftë edhe me vullnetin e saj të ketë qëndruar tek të akuzuarat pa pëlqimin e përfaqësuesit ligjor dhe se të njëjtat e kanë mbajtur për qëllim të përfitimit, shfrytëzimit të saj, po ashtu nuk është kontestuese fakti se e dëmtuara ka qenë e strehuar nga të akuzuarat në shtëpinë ku aty kanë qëndruar dhe se të njëjtat e kanë marrë me vete në çdo rast gjatë asaj periudhe kur kanë frekuentuar nëpër restorante të ndryshme, po ashtu, frekuentimi nëpër restorante është bërë me taksë të cilin e kanë paguar të akuzuarat të cilat e kanë frikësuar duke i thënë të mos e tregojë vend ndodhjen dhe kur ka shkuar në shtëpi të mos tregojë se me kënd dhe ku ka qenë, pra, të gjitha këto fakte manifestojnë elementet e veprës penale nga neni 189 par. 2 lidhur me par. 1 dhe nenin 23 të KPK-së.

Përkitazi me vendimin mbi dënimin, në ankesën e mbrojtësit të akuzuarës theksohet se edhe vendimi mbi dënimin, edhe me prezumimin se në veprimet e të akuzuarës Kosovare, përmban elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar është shumë i lartë dhe i ashpër. Nuk është kontestues fakti se gjykata me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e caktimit të dënimit, mirëpo në prezencën e një numri të madh të rrethanave lehtësuese, gjykata ka mundur të akuzuarës t'i cakton edhe një dënim më të ulët, edhe pse në të vërtetë të akuzuarës i është caktuar një dënim nën minimumin e paraparë për këtë veprë penale.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit i vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-së, ku si rrethana lehtësuese ka marrë për bazë se e akuzuara K.M, është e gjendjes së varfër ekonomike, e pa martuar, sjelljen e saj pas kryerjes së veprës penale, sjelljen korrekte gjatë procedurës, nuk ka evidenca, se është kryerëse e veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale vepra penale është kryer ndaj të dëmtuarës së mitur dhe mbi bazën e rrethanave të cekura më lartë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit e pranon edhe kjo gjykatë, e duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar gjykata e shkallës së parë, rrethanat e rastit konkret, kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i parashikuar me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së, ku do të parandalohet kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, te parandalohet personat tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Na sa u tha më lartë e në bazë të nenit 401 të KPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- PRISHTINË
PAKRnr.634/2016, me date 04.05.2016

Procesmbajtësi,

Bujar Balaj

Anëtarët e kolegjit,

1. Rasim Rasimi

2. Have Haliti

Kryetari i kolegjit,

Mejreme Memaj